



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 10, datë 18.01.2012**

**PËR**

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 111, DATË 28.07.2011 “PËR MIRATIMIN E TABELËS SË PRIMIT TË RREZIKUT, PËR PËRLLOGARITJEN E PROVIGJONEVE TEKNIKE PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË PËRGJEGJËSISË SË PRONARIT TË MJETIT MOTORIK PËR DËMET QE U SHKAKTOHEN PALËVE TË TRETA NGA PËRDORIMI I KËTIJ MJETI” TË NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 10, të Ligjit 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” të ndryshuar dhe pikës 3, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Në tabelën 1, “Të primit të rrezikut për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete për kontratat kufitare të sigurimit”, të shtohet kolona e primit të rrezikut për periudhën e mbulimit 6 mujore sipas tabelës 1 bashkangjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**NËNKRYETAR**

**Enkeleda SHEHI**